



SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT

Ë-buletin



Tetor, 2017

SBASHK-u shënoi me shumë aktivitete 5 Tetorin- Ditën Botërore të Mësuesit
**Në përpjekje për lirinë e merituar të mësuesit në
profesionin e tij të shenjtë**



Edhe këtë vit SBASHK-u në bashkëpunim me EI-në ka zhvilluar një varg aktivitete me qëllim të krenimit të Ditës Botërore të Mësuesve. Janë organizuar shumë aktivitete festive e tematike nga të cilat vlen të veçohen: U mbajt takim solemn me anëtarët e Këshillit Drejtues të SBASHK-ut... (faqe 4)

SBASHK-u u takua me Kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Në mbështetje të kolegëve tanë pensionistë



Janë bërë shembull i mirë një pjesë e Gjykatave Themelore të Kosovës(faqe 7)

SBASHK-u organizoi konferencën “Mësimdhënësit formojnë të ardhmen e Kosovës “

Kontribut me vlerë për përmirësimin e gjendjes në arsim



SBASHK-u vazhdon me kontributin konkret në përpjekjet për ngritjen e vazhdueshme ... (faqe 8)

Kuvende zgjedhore të SAF e SAM në Prizren, Viti, Gjilan, Kamenicë , Prishtinë , Han të Elezit dhe Suharekë

Atmosferë uniteti e mobilizimi për angazhime e arritje të reja

Pasi janë të angazhuar në shumë aktivitete...(faqe 11)

Intervistë me mësimdhënësen dhe sindikalistin Afërdita Krasniqi

SBASHK gjithnjë e më shumë po përfaqëson interesat e anëtarëve të saj

Afërdita tani punon në shkollën “Pavarësia” të kryeqytetit. Ajo shprehet se profesioni(faqe 3)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Krenar me SBASHK-un



Në kohë të shkuara kishte individë që flisnin me ironi për sindikatat. Kjo nuk po ndodh më, fal angazhimit, besimit dhe unitetit të krijuar në SBASHK. Vizitat e shpeshta nëpër komunat e Kosovës dhe takimi me mësimdhënës e punëtorë të tjerë të arsimit dhe bashkëbisedat vëllazërore kanë krijuar një klimë të mirëbesimit të ndërsjellë. Ky besim ka bërë që SBASHK-u të gëzojë respekt të lartë edhe të institucionet dhe organizatat vendore e ndërkombëtare. Në Uk ka takim të rëndësishëm në të cilin flitet për arsimin apo edhe për zhvillimet tjera e të mos jenë ftuar përfaqësuesit e SBASHK-ut dhe paraqitjet e tyre kanë pasur jehonë pozitive

sepse gjithmonë janë angazhuar për ecjen përpara e në shërbim të arsimit . SBASHK-u fal unitetit po arrinë të organizojë e vetë takime me peshë e në të cilat po marrin pjesë me kënaqësi udhëheqës të lartë të shtetit tonë dhe të institucioneve tjera. Ajo që është për çdo lëvdatë në këtë ngjarje të rëndësishme për arsimin është prania në numër të madh i mësimdhënësve sindikalistë nga e tërë Kosova. Ata , si në Konferencën kushtuar 5 tetorit- Ditës Botërore të Mësuesit, ashtu edhe në Konferencën “Mësimdhënësit formojnë të ardhmen e Kosovës “ dëshmuar unitetin dhe përkushtimin në kuadër të SBASHK-ut. Ata prezantuan në mënyrën më të mirë personalitetin shembullor të mësuesit.

Këta janë anëtarët e SBASHK-ut dhe ne jemi krenar me ta. Krenar me SBASHK-un.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë , mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës(SBASHK)
përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



Intervista

Intervistë me mësimdhënësen dhe sindikalisten Afërdita Krasniqi

SBASHK gjithnjë e më shumë po përfaqëson interesat e anëtarëve të saj



Afërdita tani punon në shkollën “Pavarësia” të kryeqytetit. Ajo shprehet se profesioni i mësuesit është i vështirë, por ka bukurinë e vet. Ajo apelon të gjithë kolegët në Kosovë që të angazhohen vazhdimisht në edukimin e arsimimin e brezave. Çdo gjë që e transmetojmë para

nxënësve është themeli mbi të cilën do të ndërtohet e ardhmja e tyre”, shprehet ajo.

Arsimimi sot:

Kush është Afërdita Krasniqi

Afërdita:

Afërdita Krasniqi e lindur në Prishtinë. Më 25.03.1970 e diplomuar në Fakultetin e edukimit .Në vitin 1991 fillova punën në shkollën fillore “Pjetër Bogdani “. Në këtë vatrë arsimore punova 24 vite si mësuese .Përvojën time tani e tri vite po e vazhdoj në shkollën “Pavarësia” në Prishtinë. Me gjithë vështirësitë dhe ngarkesën që e ka profesioni ynë, e ka bukurinë e vet, e cila na mban gjithmonë të rinj. Në vitin 2014 u bëra edhe anëtare e SBASHK-ut.

Arsimimi sot:

Cilat janë arsyet kryesore që ndikuan që shkolla juaj t’i bashkohet SBASHK-ut ?

Afërdita:

Shkolla jonë iu bashkua SBASHK-ut për këto arsye: SBASHK-u organizon dhe është pjesëmarrëse e shumë aktiviteteve të ndryshme , të cilat kanë si objekt arsimin. Arsye tjetër është se SBASHK gjithnjë e më shumë po përfaqëson interesat e anëtarëve të saj në fusha të ndryshme.

Arsimimi sot :

Sa është i vështirë profesioni i mësimdhënësit sot ?

Afërdita:

Mësuesi është në shërbim të nxënësve. Nuk është profesion i lehtë , mësuesi duhet të përshtatë sjelljen e tij në bazë të nxënësit që ka përball dhe duhet të përmbush nevojat e tij. Edhe pse mësimdhënësit përdorin metoda funksionale nuk ndalen , prapë kërkojnë , eksperimentojnë duke studiuar vazhdimisht të arriturat e nxënësve në të gjitha fushat e jetës. Pra të zgjedhësh këtë profesion do të thotë të jesh i përgjegjshëm . Çdo gjë që e transmetojmë para nxënësve është themeli mbi të cilën do të ndërtohet e ardhmja e tyre.

Arsimimi sot:

Cili është roli momental i femrës mësimdhënëse në SBASHK ?

Afërdita:

Gjithnjë e më shumë veprimtaritë e SBASHK-ut po e forcojnë rolin e femrës në sindikatë. Kryesisht me organizimin e trajnimeve dhe me vendosjen e femrave në pozita udhëheqëse , SBASHK ,ka arritur të përmbush planin strategjik në fushën e fuqizimit të femrës në sindikatë.

Arsimimi sot :

Çka do të veçonit nga aktivitetet dhe arritjet e SBASHK-ut ?

Afërdita:

Gjatë këtyre viteve unë e përgëzoj SBASHK-un për arritjet dhe aktivitetet që bëri në shërbim të anëtarësisë . Në veçanti vlen të përmendet kontrata individuale e punës me kohë të pacaktuar si dhe shumë marrëveshje me biznese. Duhet edhe shumë punë për arritje më të mëdha në arsim. Duhet të investohet në shkolla , të pajisen ato me kabinete duke I përfshirë edhe mjetet përkatëse , ngritja profesionale e mësimdhënëseve , plotësimi I kushteve për punë që ne disa shkolla këto kushte mungojnë.

Arsimimi sot :

Çka i sugjeroni SBASHK-ut që të fokusohet më shumë në angazhimet e veta ?

Afërdita:

SBASHK mos të ndalet deri në realizimin e kontratës kolektive në tërësi dhe të vazhdoj me organizimin e trajnimeve në mënyrë të mirë të mësimdhënësve.

Arsimimi sot:

A keni diçka për të shtuar ?

Afërdita :

Unë e vlerësoj përkushtimin e SBASHK-ut për anëtarësinë e vet . Ju lumtë dhe suksese të mëtejshme. Faleminderit për intervistën , ishte kënaqësi .

Gjatë muajit

SBASHK-u shënoi me shumë aktivitete 5 Tetorin- Ditën Botërore të Mësuesit

Në përpjekje për lirinë e merituar të mësuesit në profesionin e tij të shenjtë

Edhe këtë vit SBASHK-u në bashkëpunim me EI-në ka zhvilluar një varg aktivitete me qëllim të krenimit të Ditës Botërore të Mësuesve.



Janë organizuar shumë aktivitete festive e tematike nga të cilat vlen të veçohen: U mbajt takim solemn me anëtarët e Këshillit Drejtues të SBASHK-ut dhe u fol për festën e madhe të mësuesve kudo në botë.




Anëtarët e Këshillit Drejtues pas kësaj kanë marrë posterë dhe materiale tjera promovuese dhe i kanë shpërndarë në shkollat e komunave të tyre .



Në respekt të 5 Tetorit në Shkollën "Pjetër Bogdani" të Prishtinës është organizuar nga drejtorja , mësime dhe nxënësit një program i suksesshëm kulturor dhe është folur edhe për 5 Tetorin dhe për temën kyçe "Liria e mësime, i fuqizon mësime".

SBASHK-u po ashtu në kuadër të krenimit të 5 Tetorit ka organizuar konferencën tematike "Liria e



mësimdhënies i fuqizon mësimdhënësit". Organizimi i mirë ka bërë që në këtë Konferencë numri i pjesëmarrësve të arrijë në 163 veprimtarë sindikalë nga të gjitha qytetet e Kosovës, nga Universitetet, personalitete të larta të Qeverisë së Republikës së Kosovës në krye me Zëvendës Kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Enver Hoxhaj, rektorë, drejtorë të Drejtorive Arsimore, përfaqësues të Këshillit të Prindërve të Kosovës, dhjetëra përfaqësues të medie të shkruara e elektronike, përfaqësues të lartë të Konfederatës së Sindikatave të Kosovës dhe të shumë federatave nga Kosova dhe Shqipëria. Dhe një fotograf profesional i angazhuar nga SBASHK-u.



Në hapje të Konferencës kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj është shprehur: Të nderuar mysafirë të Konferencës tematike "Liria e mësimdhënies, fuqizon mësimdhënësit" dhe ju kolegë mësimdhënës, medie të nderuara, në çdo 5 tetor anëtarët e SBASHK-ut i bashkohen në aktivitete miliona kolegëve të tyre anë e kënd botës", për të kujtuar se y vit shënon 20 vjetorin e Rekomandimit të UNESCO-s lidhur me Statusin e Personelit të Arsimit të Lartë. Rekomandimi i vitit 1997 plotëson Rekomandimin e UNESCO-s / ILO-s të vitit 1966 lidhur me Statusin e Mësimdhënësve.

Ai pastaj ka folur për rëndësinë e kësaj date dhe në përmbyllje së fjalës përshëndetëse ka thënë: "Besoj se është ky moment i mirë që nga kjo Konferencë të përcjellim përshëndetjet më të sinqerta për mikun e



madh të arsimit në Kosovë, për Sekretarin e përgjithshëm të Internacionales Botërore të Arsimit, zotërinë Fred Van Leuwen, i cili ishte me ne në ditët më të vështira për arsimin shqip dhe vazhdon me përkrahjen e sinqertë edhe sot e gjithë kohën".

Duke përshëndetur pjesëmarrësit e Konferencës, Zëvendës Kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës, Prof. Dr. Enver Hoxhaj ka shprehur respekt të lartë për SBASHK-un, për EI-në dhe miqtë e mëdhenj ndërkombëtar të arsimit tonë.



Konferencën dhe gjithë mësuesit kudo janë në botë edhe z. Fehmi Hysenaj Këshilltar i Lartë Politik i Ministrisë të Arsimit, Shkencës e Teknologjisë, z. Shyqiri Bytyqi,



rektori i Universitetit të Prishtinës, z. Marjan Demaj, Kryetari i Konfederatës së Sindikatave të Kosovës (BSPK), z. Avni Ajdini, Kryetari i Sindikatave të Arsimit të Shqipërisë, z. Nevruz Kaptelli, Kryetari i Këshillit të Prindërve të Kosovës, z. Bajram Beqiri dhe kryetari i Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, z. Blerim Sylja.



Të gjithë këta e kanë vlerësuar lartë përkushtimin e SBASHK-ut dhe organizimin me sukses të kësaj Konference.



Në pjesën e dytë të Konferencës pjesëmarrësit kanë dëgjuar me vëmendje prezantimet e panelistëve që kishin të bënin me çështje konkrete e të argumentuara lidhur me temën "Liria e mësimdhënies i fuqizon mësimdhënësit. Në fillimet e punës së këtij paneli, kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj ka lexuar mesazhin e përbashkët drejtuar gjithë mësimdhënësve sindikalistë kudo në botë të: znj. Irina Bokova,



drejtores e përgjithshme të UNESCO-s, Guy Ruder, drejtor i përgjithshëm i ILO-s, Anthony Lake, drejtor i përgjithshëm i UNICEF-it, z. Achim Steiner, administrator i UNDP-së dhe z. Fred Van Leuwen, sekretar i përgjithshëm i Internacionales Botërore të Arsimit.



Pas kësaj kanë filluar panelistët me prezantimet e tyre. Prof. Dr. Atdhe Hykolli nga Fakulteti i Edukimit ka

zgjuar kureshtjen e pjesëmarrësve me temën "Liria e mësimdhënies dhe reflektimi i saj në cilësinë". Është përcjellë me shumë vëmendje edhe prezantimi tematik "Mësimdhënësi model" i Prof. Dr. Alejtin Berisha dhe prezantimi i prof. Alma Lama nga Sindikata e Arsimit të Shqipërisë.

Në pjesën e tretë të Konferencës pjesëmarrësit kanë shtruar shumë pyetje drejtuar panelistëve, të cilët kanë dhënë përgjigje konkrete. Konferenca ka autorizuar në fund panelistin Prof. Dr. Atdhe Hykolli që bashkë me ekspertë të SBASHK-ut të përgatitin rekomandime nga kjo Konferencë, të cilat do t'i dërgohen EI-së, si informacion, dhe Institucioneve qendrore e lokale të Kosovës.



Të theksojmë se mediet i kanë kushtuar rëndësi të veçantë këtyre aktiviteteve duke e përcjellë e raportuar për Konferencën dhe duke e ftuar dy televizione qendrore kryetarin e SBASHK-ut në emisione kushtuar 5 tetorit – Ditës Botërore të Mësimdhënësve.

SBASHK-u u takua me Kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Në mbështetje të kolegëve tanë pensionistë

Janë bërë shembull i mirë një pjesë e Gjykatave Themelore të Kosovës të cilat në kohën më të shpejtë të mundshme janë duke i trajtuar lëndët e dërguara nga SBASHK-u lidhur me tri pagat jubilarë dhe tri pagat përcjellëse me rastin e pensionimit të

anëtarëve të SBASHK-ut, mirëpo një pjesë tjetër e gjykatave nuk e kanë përcjellur shembullin e mirë të kolegëve të tyre dhe prandaj me qëllim që këto lëndë të trajtohen me prioritet, ashti si e përcakton edhe ligji,

kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj , i shoqëruar nga këshilltari për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri janë takuar me kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, z. Nehat Idrizi.



“ Kërkesa jonë ka mbështetje ligjore, por ka edhe elementin human sepse SBASHK-u kishte tentuar me dialog të arrijë me qeveritë lokale që ata t’i përmbushin si punëdhënës obligimet nga Kontrata Kolektive e sektorit të arsimit duke u dhënë të pensionuarve nga ky sektor nga tri paga suplementare

dhe tri paga përcjellëse. Puna e përkushtuar e këtyre njerëzve sidomos në vitet e okupimit ka lënë gjurmë në shëndetin e tyre dhe nëse zvarriten nga gjykatat lëndët lidhur me kërkesën e tyre dhe të SBASHK-ut, atëherë shumë nga ta edhe mund të shkojnë në amshim pa gëzuar këtë të drejtë”, është shprehur kryetari i SBASHK-ut në takim me Kryesuesin e KGJK-së.

Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, z. Nehat Idrizi ka shprehur respektin e tij për punën e përkushtuar të punëtorëve të arsimit e sidomos në vitet e vështira të okupimit dhe ka premtuar se do t’u dërgoj shkresë zyrtare kryetarëve të Gjykatave Themelore në gjithë Kosovën me kërkesën që lëndët e dërguara nga SBASHK-u lidhur me tri pagat suplementare dhe tri pagat përcjellëse me rastin e pensionimit të trajtohen me prioritet.

SBASHK-u organizoi konferencën “Mësimdhënësit formojnë të ardhmen e Kosovës “

Kontribut me vlerë për përmirësimin e gjendjes në arsim



SBASHK-u vazhdon me kontributin konkret në përpjekjet për ngritjen e vazhdueshme të cilësisë në arsim. Në kuadër të këtij përkushtimi e në bashkëpunim me GIZ ka organizuar edhe Konferencën “Mësimdhënësit formojnë të ardhmen e Kosovës “

Përkushtimi i SBASHK-ut në përgatitjen sa më të mirë të kësaj ngjarje me rëndësi ka dhënë frytë këtë të premte ngase kjo ngjarje ka pasur rrjedhë të mbarë dhe ka shënuar një pjesëmarrje më të madhe të mësimdhënësve e mysafirëve nga ajo që ishte planifikuar nga Këshilli organizativ i SBASHK-ut.

“SBASHK-u vazhdimisht ka insistuar në të vërtetën se : Duke pasur parasysh rëndësinë e sistemit arsimor për një shoqëri, e posaçërisht për Kosovën , si shtet i ri e me një numër të madh të të rinjve, secili duhet të kontribuojë dhe të bashkëpunojë për të arritur cakun e dëshiruar.



Prandaj, po e them edhe këtu e në emër të gjithë anëtarësisë së SBASHK-ut se në këtë përpjekje

madhore duhet të përfshihen sinqerisht, krahas punëtorëve të arsimit, edhe nxënësit, prindërit, institucionet lokale e qendrore të shtetit dhe palët tjera, jo duke kritikuar pa as edhe një argument, por duke u angazhuar konkretisht në këtë mision të shenjtë”, është shprehur në hapje të Konferencës, kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, i cili pastaj ka falënderuar z. Boris Sharlovskin dhe stafin e GIZ për mbështetjen në organizimin e kësaj ngjarje dhe për angazhimin e sinqertë në ngritjen e cilësisë në arsimin e Kosovës.



Udhëheqësi i Projektit, Boris Scharlovski nga GIZ, ka lavdëruar angazhimin e SBASHK-ut, jo vetëm tani, por edhe në të kaluarën, që përveç mbrojtjes me sukses të të drejtave të mësimdhënësve dhe realizimit të kërkesave të tyre po angazhohet vazhdimisht edhe në ngritjen e vazhdueshme të cilësisë në arsim.

“Ne të gjithë i dimë rezultatet të PISA-s të cilat janë publikuar pothuajse para një viti, mirëpo ne jemi të informuar edhe me sfidat kryesore me të cilat ballafaqohet sistemi arsimor në Kosovë.



Siç ne të gjithë e dimë, arsimi është një e drejtë, mirëpo gjithashtu nevojitet një zotim nga e tërë shoqëria për të zhvilluar atë”, është shprehur përfaqësuesi i GIZ-it në fjalën e tij përshëndetëse drejtuar pjesëmarrësve të Konferencës. Duke i përshëndetur pjesëmarrësit dhe SBASHK-un për organizimin e këtij aktiviteti shumë të qëlluar.



Ministri i MASHT, z. Shyqiri Bytyqi ka vlerësuar lartë rolin dhe përkushtimin e mësimdhënësve të vendit tonë në të kaluarën e vështirë, por edhe tani e gjithmonë. “Mësimdhënësit janë baza e arsimit. Sa më e fortë dhe e qëndrueshme të jetë kjo bazë, aq më i fuqishëm do të jetë sistemi i arsimit dhe si rezultat e ardhmja jonë do të jetë e sigurt”, është shprehur Ministri Bytyqi.



Kryetari i Komisionit Parlamentar për Arsim në Parlamentin e Republikës së Kosovës, Ismajl Kurteshi ka përgëzuar SBASHK-un për gjithë arritjet dhe për organizimin kaq në nivel të kësaj Konference. Ai ka kujtuar se kanë kaluar 10 muaj që kur është provuar

rezoluta që arsimin e vë si prioritet, por nuk është bërë që në këtë drejtim. “Deri më tani nuk kemi parë asnjë lëvizje në këtë drejtim, por jam i sigurt se me angazhimin e mësimdhënësve, të SBASHK-ut dhe të organizatave tjera, MASHT do të fillojë ta vë në jetë rezolutën e cila sipas mendimit tim është rezoluta më e rëndësishme që Kuvendi i Kosovës ka aprovuar”, ka cekur Kurteshi



” Vërtetë janë mësimdhënësit ata që formojnë të ardhmen e vendit dhe prandaj që arsimi meriton të bëhet prioritet i vendit”, është shprehur prorektorja Myrvete Badivuku, e cila në fjalën e saj përshëndetëse ka lavdëruar SBASHK-un për angazhimet dhe arritjet e shumta.



Kanë lavdëruar angazhimet e SBASHK-ut edhe kryetari i BSPK-së, Avni Ajdini, kryetari i Këshillit të

Prindërve të Kosovës, z. Bajram Beqiri dhe në merr të DKA-ve të Kosovës, z. Qahil Sinani.



Në pjesën e dytë të Konferencës, udhëheqësja e Sektorit të Trajnimeve në MASHT, znj. Igballe Cakaj, ka prezantuar temën “Pasqyra e përgjithshme e vizionit të arsimit për të ardhmen”



Temën “Filozofia e PISA, implikimet në sistemin e arsimit dhe në shkollë”, e ka ligjëruar profesori në

fakultetin Edukimit , z Atdhe Hykolli.



Do theksuar se ishte tema “Kontributi, roli dhe përgjegjësitë e mësimeve” e ligjëruar nga asistenti në Fakultetin e Gazetarisë, z. Alban Zeneli, që ka zgjuar shumë interesimin e pjesëmarrësve .



.Pas kësaj është punuar në tri grupe dhe pjesëmarrësit kanë dhënë kontributin e tyre lidhur me tri temat e ligjëruar duke nxjerrë edhe konkluzione konkrete që janë bazë e mirë e angazhimeve në përpjekje për ndryshime pozitive në sektorin e arsimit.

Kuvende zgjedhore të SAF e SAM në Prizren, Viti, Gjilan, Kamenicë , Prishtinë , Han të Elezit dhe Suharekë

Atmosferë uniteti e mobilizimi për angazhime e arritje të reja

Pasi janë të angazhuar në shumë aktivitete e me qëllim që të realizohet brenda afateve të parapara agjenda e zgjedhjeve nëpër Kuvendet e SAF e SAM nëpër komunat e Kosovës, kryetari i SBASHK-ut bashkë me menaxherin për financa e administratë e këshilltar për organizim të brendshëm Ymer Ymeri kanë hasur në mirëkuptim nga kolegët e tyre në komunat e Kosovës dhe kështu Kuvendet zgjedhore po mbahen edhe ditëve të vikendit e madje edhe ditën e diel . Duke realizuar kështu agjendën e paraparë janë mbajtur

Kuvende zgjedhore në n ë Prizren, Viti, Gjilan, Kamenicë , Han të Elezit dhe Suharekë.

Në mënyrë të plotë lexues të nderuar lidhur me gjithë këto aktivitete ju kemi informuar në mënyrë të plotë në ueb faqen tonë, kurse për këtë numër të gazetës suaj “Arsimimi sot” po kujtojmë momente nga këto zgjedhore.

Në Prizren unitet e përkushtim për arritje të reja

Në një atmosferë uniteti e përkushtimi është mbajtur Kuvendi zgjedhor i SAF e SAM në Prizren.



Kryetari i këtij Kuvendi Reshit Kushaj ka përshëndetur kryetarin e SBASHK-ut , Rrahman Jasharaj dhe menaxherin për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri e pastaj ka prezantuar raportin e punës dhe atë financiar.



Pas kësaj është kaluar në zgjedhje dhe me votë të fshehtë e në një garë të fortë e mes shumë kandidatëve është zgjedhur kryetari, nënkryetari, anëtarët e kryesisë, anëtarët e Komisionit mbikëqyrës, delegatët për Kongresin e SBASHK-ut dhe përfaqësuesit e kësaj komune në Këshillin Drejtues të SBASHK.

Besim i plotë në SBASHK_un edhe në Viti

Edhe pse ishte e dielë anëtarët e Kuvendit të SAF e SAM të Vitisë i ishin përgjigjur ftesës së kryetarit të tyre Kemajl Bislmi dhe kishin ardhur në takimin zgjedhor.



Edhe këtu ishin të pranishëm kryetari i SBASHK-ut , Rrahman Jasharaj dhe menaxheri për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri .Kryetari i SAF e SAM për Vitinë, Kemajl Bislmi fillimisht ka prezantuar raportin e punës dhe atë finciar.



Pas kësaj edhe këtu është zhvilluar procesi zgjedhor përmes votës së fshehtë mes shumë kandidatëve. Anëtarët e këtij Kuvendi me votën e tyre kanë zgjedhur organet udhëheqëse të tyre dhe delegatët për Kongresin e SBASHK-ut dhe përfaqësuesit për Këshillin Drejtues.

Atmosferë festive në Gjilan

Në një atmosferë festive është mbajtur po të dielën edhe Kuvendi i SAF e SAM për komunën e Gjilanit. Kryetari Blerim Mehmeti me kryesinë e veprimtarë të tjerë kishin bërë që çdo gjë të ketë pamjen e një ngjarje të rëndësishme.



Kryetari Mehmeti ka përshëndetur për pjesëmarrjen kryetarin e SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, menaxherin për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri, kryetarin e BSPK-së, Avni Ajdini dhe nënkryetarin nga SBASHK-u në BSPK, z. Atdhe Hykolli. Ai pastaj në mënyrë të detajuar e me plot argumente e fakte ka prezantuar raportin e punës dhe atë financiar.



Pas kësaj është kaluar në procesin e votimit dhe përmes votave të fshehta e në një konkurrencë të fortë janë zgjedhur kryetari, nënkryetari, kryesia, Komisioni mbikëqyrës, delegatët për Kongresin e SBASHK-ut dhe përfaqësuesit në Këshillin Drejtues.

Edhe në Prishtinë është mbajtur Kuvendi zgjedhor i SAF e SAM

Në hapje të Kuvendit zgjedhor të SAF e SAM për komunën e Prishtinës, kryetari i këtij Kuvendi, Ahmet Pllana ka përshëndetur kryetarin SBASHK-ut, Rrahman Jasharajn dhe menaxherin për financa e administratë e këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri e pastaj ka paraqitur raportin e punës dhe atë financiar.



Pasi kanë dëgjuar këto dy raporte pjesëmarrësit e ëktij takimi kanë lavdëruar angazhimin e z. Pllana dhe të SBASHK-ut në tërësi duke kërkuar që një atmosferë e tillë e unitetit dhe e mobilizimit për angazhime të reja të vazhdojë edhe në të ardhmen.



Menaxheri për financa e administratë e këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri, që në takimet e Kuvendeve zgjedhore është në cilësinë e kryetarit të komisionit statutar ka kujtuar nenet e Statusit që kanë të bëjnë me zgjedhjet në nivelin komunal të organizimit sindikal .



Pas kësaj është kaluar në propozimin e kandidatëve për funksionet gjegjëse e më pastaj edhe në votimin e tyre.

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Në Kamenicë , po ashtu, unitet dhe gatishmëri arritje të reja

Në realizim të agjendës zgjedhore nëpër komunat e Kosovës është mbajtur edhe takimi zgjedhor i SAF e SAM për komunën e Dardanës (Kamenicës).



Në hapje të këtij takimi kryetari Nazim Jakupi ka falënderuar për pjesëmarrje kryetarin e SBASHK-ut, Rahman Jasharaj dhe menaxherin për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri, i cili në këto Kuvende zgjedhor merr pjesë në cilësinë e kryetarit të Komisionit statutar. Pas kësaj kryetari Jakupi ka paraqitur raportin e punës dhe atë financiar, që janë aprovuar nga anëtarët e Kuvendit.



Kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj ka përshëndetur pjesëmarrësit dhe ka lavdëruar unitetin dhe angazhimet sindikale edhe në këtë komunë.

Në pjesën e dytë të punimeve të këtij Kuvendi është kaluar në procesin e zgjedhjeve për kryetar dhe organe të tjera sindikale.

Atmosferë e mirë në Kaçanik

Në kuadër të realizimit të agjendës së zgjedhjeve në nivelin komunal, u mbajt Kuvendi zgjedhor i SAF e

SAM për komunën e Kaçanikut.



Në hapje të këtij takimi kryetari i deri tashëm Zeqir Krasniqi ka përshëndetur kryetarin e SBASHK-ut , Rahman Jasharaj, anëtarin e kryesisë Murat Abazin dhe menaxherin për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm, i cili në këtë takim ishte edhe në cilësi të kryetarit të Komisionit statutar. Pas kësaj z. Krasniqi ka prezantuar raportin e punës dhe atë financiar. Në pjesën e dytë të këtij takimi është filluar me procesin zgjedhor për kryetarin, nënkryetarin dhe organet tjera.



Anëtarët e këtij Kuvendi me votë të fshehtë i kanë dhënë besimin kolegut të tyre Fevzi Bunjaku, që të udhëheqë në 4 vitet e ardhshme këtë Kuvend dhe aktivitetet sindikale të SBASHK në Kaçanik. Janë zgjedhur edhe nënkryetari , anëtarët e kryesisë, delegatët e Kongresit, Komisioni mbikëqyrës dhe përfaqësuesit e kësaj komune në Këshillin Drejtues.

Është mbajtur Kuvendi zgjedhor i SAF e SAM edhe në Hanin e Elezit

Edhe pse në komunën e Hanit të Elezit është një numër i vogël shkollash dhe prandaj edhe numri i punëtorëve të arsimit është i vogël, krahasuar me



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

komunat tjera, bie në sy uniteti i lartë i sindikalistëve këtu.



Pra, në Han të Elezit janë të pakët në numër por shumë unik në SBASHK. Edhe në këtë komunë është mbajtur Kuvendi zgjedhor i SAF e SAM dhe janë zgjedhur përmes votës së fshehtë kryetari dhe organet tjera të Kuvendit dhe përfaqësuesit për Kongresin dhe Këshillin Drejtues të SBASHK-ut.

U mbajt Kuvendi zgjedhor i SAF e SAM edhe për komunën e Therandës



Pas daljes në pension të kryetarit dhe veprimtarit të dalluar sindikal, Sadik Shala, në Suharekë ishte mbajtur Kuvendi zgjedhor për zgjedhjen e kryetarit dhe me vota të fshehta e një konkurrencë të denjë ishte zgjedhur Murat Bytyqi. Për të bërë zgjedhjen edhe të organeve tjera të SAF e SAM në këtë komunë u mbajt një Kuvend tjetër zgjedhor këtë të martë.



Në fillimet e punimeve të Kuvendit kryetari Bytyqi ka përshëndetur dhe ka falënderuar për pjesëmarrjen kryetarin e SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, menaxherin për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri, që në këtë takim ishte në cilësinë e kryetarit të Komisionit statutar dhe juristin e SBASHK-ut, Blendor Shatri.



Pas kësaj ai ka prezantuar raportin e punës dhe atë financiar. Kryetari i SBASHK-ut ka përshëndetur pjesëmarrësit në këtë takim duke ritheksuar se uniteti dhe besimi i ndërsjellë ka bërë që në SBASHK të shënohen rezultate dhe arritje. Pas kësaj është kaluar në procesin zgjedhor dhe me votën e fshehtë është zhvilluar një garë e fortë për çdo pozitë udhëheqëse në këtë Kuvend.

Të theksojmë se pjesëmarrësit në të gjitha këto Kuvende zgjedhore duke shprehur respekt e përkrahje për angazhimin e përkushtuar të kryetarit të SBASHK-ut, Rahman Jasharaj e kanë kandiduar e mbështetur atë që ta udhëheq SBASHK-un edhe për një mandat.

